



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 10.02.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 ,e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.02.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “TRIANGLE” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Re-Tender-II-të-Ndërtimi i Qendrës së Biznesit-faza-II-të”, Nr. i prokurimit- 632-25-5966-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-028-521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “TRIANGLE” SH.P.K., e dt.05.02.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Re-Tender-II-të-Ndërtimi i Qendrës së Biznesit-faza-II-të”, Nr. i prokurimit- 632-25-5966-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-028-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 02.02.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:02.02.2026;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “TRIANGLE” SH.P.K., me dt.05.02.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Re-Tender-II-të-Ndërtimi i Qendrës së Biznesit-faza-II-të”, Nr. i prokurimit- 632-25-5966-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-028-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 10.02.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi 1, Kërkesat mbi mundësit teknike dhe / ose profesionale 9.1&9.2, pika a) :

Kërkesa: Një (1) Menaxher të Projektit - Inxhinier i nivelit Master (ose me sistemin e vjetër inxh. i diplomuar) në Inxhinierinë e Ndërtimit, drejtimi Konstruktiv me 10 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.

Dëshmia: Kopja e Diplomës përkatëse, CV e nënshkruar nga inxhinieri/ja, referenca që tregojnë përvojën e kërkuar profesionale, kontratë e nënshkruar ndërmjet punëdhënësit dhe inxhinierit/es për këtë projekt si dhe Vendimi për Menaxher të projektit i nënshkruar dhe vulosur.

Kandidati i propozuar Karafidin Kuka :

1. Kandidati ka diplomuar me dt. 05.10.1989 – Shiko diplomën e prezantuar e jo siç pretendoni ju se ka diplomuar në vitin 2003.
2. Sipas diplomës, referencës dhe CV që ka prezantuar OE, ky Ing e plotëson në mënyrë të saktë përvojën e punës profesionale pas diplomimit që është kërkuar me 10 vite përvojë pune.
3. Nuk ka asnjë mospërputhje , i njëjti ka plotësuar kriterin sipas kërkesës së tenderit.

Pretendimi 2, Kërkesat mbi mundësit teknike dhe / ose profesionale 9.1&9.2, pika ç)

Kërkesa: Një (1) Inxhinier i nivelit Master (ose me sistemin e vjetër inxh. i diplomuar) në Inxhinierinë e Ndërtimit, drejtimi Hidroteknikë, me 3 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.

Dëshmia: Kopja e Licencës përkatëse, CV e nënshkruar nga inxhinieri/ja, referenca që tregojnë përvojën e kërkuar profesionale, kontratë e nënshkruar ndërmjet punëdhënësit dhe inxhinierit/es për këtë projekt.

Kandidati i propozuar Blerina Stublla Statovci :

1. Lidhur me përvojën e punës së Ing, OE ka prezantuar diplome me date 30.07.2020, që nënkupton më shumë se 5 vite pas diplomimit.
2. Pretendimi i juaj nuk qëndron sepse kandidatja ka prezantuar referencat nga N.N. “Blini Term” e punësuar nga data 10.01.2023 e që është ende duke vazhduar punën. Referenca e lëshuar tregon llojin e punës me objekte të cekura ndërtimore në lëminë e Hidroteknikës ku ka punuar dhe është duke vazhduar punën. Poashtu ka një referencë nga “Suisse company” SH.P.K. në të cilën ka punuar nga 15.12.2019 deri më 30.09.2021.
3. Sipas dokumentacionit të ofruar përvoja e punës pas diplomimit është më se 3 vite që e plotëson kriterin e kërkuar në DT.

Pretendimi 3, Kërkesat mbi mundësit teknike dhe / ose profesionale 9.1&9.2, pika e)

Kërkesa: Një (1) Inxhinier i nivelit Master (ose me sistemin e vjetër inxh. i diplomuar) Inxhinierinë Mekanike, drejtimi Termoenegjetikë dhe Termoteknikë, me 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.

Dëshmia: Kopja e Diplomës përkatëse, CV e nënshkruar nga inxhinieri/ja, referenca që tregojnë përvojën e kërkuar profesionale, kontratë e nënshkruar ndërmjet punëdhënësit dhe inxhinierit/es për këtë projekt.

Kandidati i propozuar Gazmend Krasniqi :

1. Kandidati i propozuar nga OE i plotëson kërkesat tërësisht sipas DT. Diploma Inxhinjeri Mekanike, Departamenti i Termoteknikës dhe Termoenegjetikës , drejtimi Teknika e ngrohjes dhe Termoteknika.
Drejtimet janë plotësisht me program të njëjtë. “Teknika e ngrohjes është identike me Termoteknikë”, prej nga kemi marr edhe përgjigjen nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë.

Pretendimi 4, Kërkesat mbi mundësit teknike dhe / ose profesionale 9.1&9.2, Lloji i mekanizmit dhe pajisjet

f) Kërkesa: Skele 700 m2

1. OE ka prezantuar kontrate me OE "Fla-Ba Na" për shfrytëzim të skeleve.
2. Dëshmia e ofruar pas kërkesës për sqarime e cila i është kërkuar, është dokumentuar me dokumente shtesë që e plotëson sasinë e kërkuar prej më shumë se 700 m² skele.

Pretendimi 5, Kërkesat mbi mundësit teknike dhe / ose profesionale 9.1&9.2, pika f)

f) Kërkesa: Të paktën një nga inxhinierët e kërkuar të jetë i certifikuar për menaxhimin e projekteve - IPMA.

Dëshmia: Licenca përkatëse e lëshuar nga subjekte te licencuar,

Përgjigje: Bazuar në kërkesën dhe dëshminë:

OE "Triangle" ka prezantuar Certifikatë pjesëmarrje në trajnim 15 ditor për Menaxhimin e projekteve të lëshuar nga projekti Kosvet IV dhe Oda Ekonomike e Kosovës e mbajtur në vitin 2009. Kjo nuk është certifikatë IPMA dhe as Licencë e lëshuar nga një subjekt i licencuar nga IPMA.

- Sipas kërkesës së FDT dhe njoftimit për kontratë është kërkuar "Të paktën një nga inxhinierët e kërkuar të jetë i certifikuar për menaxhimin e projekteve - IPMA", dhe deri në hapjen e këtij aktiviteti nuk kemi pasur kërkesa për sqarime shtesë lidhur me këtë pikë
- Certifikata e kërkuar në FDT duhet të jetë valide dhe e lëshuar nga IPMA, me logon e tyre dhe e cila lëshohet nga një subjekt i autorizuar. Në dokument duhet të shënohet niveli i certifikimit dhe data e vlefshmërisë.
- Dokumenti i prezantuar nga ana e OE "Triangle" nuk mund të pranohet sepse nuk është certifikim i licencuar IPMA sipas kërkesës në FDT.
- AK ka bërë kërkesë për sqarim pranë Institucionit IP Certification Prishtine dhe kemi marrë përgjigje të cilën ja bashkëngjisim kësaj shkrese.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj


Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Besim Haxhija

From: UBT Info <info@ubt-uni.net>
Sent: Wednesday, February 4, 2026 10:38 AM
To: Besim Haxhija
Cc: UBT Trajnime
Subject: Re: Kerkse për sqarim

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Te nderuar,

JU lutem shihni me poshte konfirmimet nga Zyra e Trajnimeve per ceshtjen qe ju keni paraqitur ne emailin tuaj.

a) Certifikata e trajnimit (Project Management Training)
Certifikata e parë dëshmon pjesëmarrje në trajnim për menaxhim projekti.
Ajo nuk është certifikim IPMA, por vetëm vërtetim i ndjekjes së një trajnimi.

b) Certifikata IPMA® Level D – Certified Project Management Associate
Certifikata e dytë është certifikim i vlefshëm IPMA, i lëshuar nga IPC Kosovo .

Me respekt,

From: Besim Haxhija <besim.haxhija@rks-gov.net>
Sent: Wednesday, February 4, 2026 9:25 AM
To: UBT Info <info@ubt-uni.net>
Cc: Faton Gutaj <faton.gutaj@rks-gov.net>
Subject: FW: Kerkse për sqarim

I/e nderuar

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës është fazën e vlerësimit të një aktiviteti të Prokurimit. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet kanë prezantuar Certifikatat të ndryshme njëra me tjetrën.
Kërkesa e aktivitetit të prokurimit në Dosjen e tenderit ka qene: f.) Të paktën një nga Inxhinierët e kërkuar të jetë i certifikuar për menaxhimin e projekteve – IPMA.

Bashkangjitur gjeni certifikatat e prezantuara nga OE.

Kërkojmë nga ana e Juaj a janë identike këto certifikata. Përgjigjja në këtë pikë neve si Autoritet do të na ndihmojë shumë për vlerësimin e drejt profesional.

E vlerësojmë përgjigjen nga ana e Juaj!

Me respekt
Besim Haxhija
Zyrtar i Larte i Prokurimit
Zyra e Prokurimit
Komuna Gjakove

From: Besim Haxhija
Sent: Wednesday, January 21, 2026 1:47 PM
To: 'info@ipcert.org' <info@ipcert.org>
Cc: Faton Gutaj <faton.gutaj@rks-gov.net>
Subject: Kerkse për sqarim

I/e nderuar

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës është fazën e vlerësimit të një aktiviteti të Prokurimit. Operatoret Ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet kanë prezantuar Certifikatat të ndryshme njëra me tjetrën. Kërkesa e aktivitetit të prokurimit në Dosjen e tenderit ka qene: f.) Të paktën një nga inxhinierët e kërkuar të Jetë i certifikuar për menaxhimin e projekteve – IPMA.

Bashkangjitur gjeni certifikatat e prezantuara nga OE.

Kërkojmë nga ana e juaj a janë identike këto certifikata. Përgjigjja në këtë pikë neve si Autoritet do të na ndihmojë shumë për vlerësimin e drejt profesional.

E vlerësojmë përgjigjen nga ana e Juaj!



XK-D-07-2023

IP Certification
International Professional
Evaluation and Certification

Certificate

This is to certify that

Blerina Stublla Statovci

has attained the required level of competence to be granted

Certified Project Management Associate

IPMA® Level D

by IPC Kosova

the Certification Body of IPMA using
the IPMA ICR4 and IPMA ICB4 as validated by
the International Project Management Association (IPMA®).


This certification process was conducted in the
Albanian language.

23/08/2023

Date of Issue

Prof. Dr. Edmond Halilaj

For the Certification Body



IPMA®

International
project
management
association

22/08/2028

Certification valid until

Dr. Luzim Beqiri

For the Assessors